



V E N D I M
K.P.P. 763/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “Toni Security” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF- 80800-07-26-2018 me objekt: “Shërbimi me roje private për ASHR”, me fond limit 14.227.576 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Shëndetësor Rajonal. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqëritë “International Security Albania” sh.p.k, “Pelikani Security Group” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k.

Ankimues:

“Toni Security” sh.p.k
Rr. “Lidhja e Prizrenit”, Nj.B. nr.5, Pll.10/1, Kati parë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Shëndetësor Rajonal
Rr. “Qamil Guranjaku”, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

International Security Albania” sh.p.k
Blv “Zogu i Parë”, P. Nr.55/1, Shk.1, Kati 2, Ap.9,
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.07.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr.REF-80800-07-26-2018 me objekt: “*Shërbimi me roje private për ASHR*”, me fond limit 14.227.576 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Shëndetësor Rajonal.

II.2. Në datën 13.09.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. “International Security Albania” sh.p.k | 14.227.206 lekë, kualifikuar |
| 2. “Pelikani Security Group” sh.p.k | 14.227.206 lekë, skualifikuar |
| 3. “Eurogijci Security” sh.p.k | 14.227.206 lekë, skualifikuar |
| 4. “Leksi Security” sh.p.k | 14.227.206 lekë, skualifikuar |
| 5. “Toni Security” sh.p.k | 14.227.206 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentin:

“a- Nuk ploteson kriterin per Akt-miratimin e Salles Operative pasi sipas ligjit 75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike Kreu VII Germa D pika 5 thote shprehimisht se Miratimi i Qendres se kontrollit te SHPSE-ve behet nga Drejtori i Drejtorise Vendore te Policise, bazuar ne KSHKC-se ne çdo dy vjet, sipas modelit bashkelidhur ketij udhezimi. AktMiratimi i Qendres se Kontrollit i paraqitur nga O.Ekonomik Eurogjici Security eshte i dates 27.08.2015, eshte jashte afatit 2-vjecar sic parashikon udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem, Kreu VII Germa D pika 5.

b- Nuk ka paraqitur certifikatat e trajnimit për personelin e SHPSF-së per përgjegjës shërbimi për SHPSF-në, për operator për Qendrën e Kontrollit, për punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve të alarmit, te parashikuar ne nr. 130, datë 5.3.2018 Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike KREU III germa A pika 2 .

c- Nuk keni paraqitur certifikatat e vlefshme per punonjesit e sherbimit sipas ligjit 75/2014.”

II.3. Në datën 18.09.2018 operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si dhe duke ngritur pretendime për shoqëritë “International Security Albania” sh.p.k, “Pelikani Security Group” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k. Konkretisht pretendohet si më poshtë vijon:

“Kundërshtojmë arsyen e parë të skualifikimit që ka të bëjë me ... a- Nuk ploteson kriterin per Akt-miratimin e Salles Operative pasi sipas ligjit 75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, Kreu VII Germa D pika 5 thote shprehimisht se: Miratimi i Qendres se kontrollit te SHPSE-ve behet nga Drejtori i Drejtorise Vendore te Policise, bazuar ne KSHKC-se ne çdo dy vjet sipas modelit bashkelidhur ketij udhezimi. AktMiratimi i Qendres se Kontrollit i paraqitur nga O.Ekonomik Eurogjici Security eshte i dates 27.08.2015, eshte jashte afatit 2-vjecar sic parashikon udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem, Kreu VII Germa D pika 5.”

Së pari, shoqëria jonë nuk quhet “Eurogjici Security” sh.p.k, sic është referuar në arsyn e skualifikimit më sipër.

Së dyti, akt miratimi i shoqërisë sonë është me nr. 96/272, datë 11.11.2015 dhe jo i datës 27.08.2015, sikundër është referuar në arsyn e skualifikimit më sipër.

Së treti, akti i miratimit i paraqitur nga shoqëria jonë është lëshuar në bazë të Udhëzimit nr. 308, datë 22.05.2017 të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe të qendrës së trajnimit privat të punonjësve të SHPSF-së.”

Së katërti, referuar Kreu IX, “Dispozita përfundimtare”, pika 6 e Udhëzimit nr. 130, datë 22.05.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, ku theksohet në mënyrë taksative se:

“Aktet e nxjerra në zbatim të udhëzimit nr.308, datë 22.05.2017 të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të SHPSF-së”, mbeten në fuqi.”

Së pesti, referuar Kreut VI “Dispozita përfundimtare”, pikës 6 të Udhëzimit nr.308, datë 22.05.2018 të Ministrit të Brendshëm “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit privat të punonjësve të SHPSF-së”, theksohet se:

“Miratimi i qendrës së kontrollit të SHPSF-ve bëhet me komision nga Sektori i Rendit Publik në Drejtorinë Vendore të Policisë, me afat 4 vjet, sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.”

Në përmbushje të kriterit kualifikues, shoqëria jonë ka akt-miratimin për Qendrën e Kontrollit për Qarkun Tiranë me nr. 96/272 prot., datë 11.11.2015. Ky akt është lëshuar në bazë të Udhëzimit nr.308, datë 22.05.2017 dhe bazuar në këtë udhëzim, aktmiratimi ka afat 4 vjet dhe konkretisht deri në datën 11.11.2019.

Referuar Kreut IX “Dispozita përfundimtare”, pikës 6 të Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të Minsitrit të Brendshëm “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, ky akt mbetet në fuqi në fund të afatit të përfundimit. [...].

II)Kundërshtojmë arsyen e dytë dhe të tretë të skualifikimit që ka të bëjë me “b- Nuk ka paraqitur certifikatat e trajnimit për personelin e SHPSF-së për përgjegjës shërbimi për SHPSF-në, për operator për Qendrën e Kontrollit, për punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve të alarmit, të parashikuar në ... nr. 130, datë 5.3.2018 Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike KREU III germa A pika 2 . c- Nuk keni paraqitur certifikatat e vlefshme për punonjësit e shërbimit sipas ligjit 75/2014”.

Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit pasi është e bazuar mbi kritere të pa kërkuara në dokumentat e tenderit, rrjedhimisht e paligjshme dhe tendencioze.

Nga verifikimi i kritereve të vecanta të kualifikimit rezulton se në asnjë pikë të tyre nuk është kërkuar paraqitja e ndonjë prej certifikatave të përmendura në arsyet e skualifikimit.

Pra skualifikimi është bërë mbi bazën e kritereve të paqena dhe të pakërkuara cka e bën skualifikimin e shoqërisë sonë absolutisht të pavlefshme. [...] Autoriteti kontraktor është i detyruar të bëjë vlerësimin vetëm mbi bazën e kritereve të publikuara në dst dhe nuk mund të përdorë asnjë kërkesë apo kriter që nuk është parashikuar në dst.

III)Kundërshtojmë kualifikimin e shoqërisë “International Security Albania” sh.p.k për arsyet si më poshtë:

1.Referuar ekstraktit të shoqërisë, rezulton se operatori ekonomik në datën 21.04.2015 ka shtuar dhe mbyllur adresat si në vijim:

-Është shtuar adresa Tiranë, Njësia Bashkiake nr.9, Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9.

-Është hequr adresa Tiranë, Rruga e Durrësit , ish Uzina Tirana, Laprakë.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit AK ka kërkuar:

“Vërtetim lëshuar nga Bashkia/Njësi administrative me anë të të cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2015-2016-2017 për adresat ku ka ushtrur apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas ekstraktit historik lëshuar nga QKR.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm, referuar informacioneve nga Bashkia, rezulton se operatori ekonomik disponon dhe ka paraqitur dokumentacionin si në vijim:

- *Vërtetim datë 26.02.2018, lëshuar nga Bashkia Tiranë, me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2018.*
- *Vërtetim datë 20.04.2017, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2017.*
- *Vërtetim datë 02.06.2015, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2015.*
- *Vërtetim datë 21.03.2014, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2011, 2012, 2013, 2014.*

Nga sa më sipër rezulton se, operatori ekonomik ka dështuar në përmbushjen e kriterit për arsye se për adresën Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, subjekti nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Tiranë që të vërtetonte se ka shlyer taksat për vitin 2015 për adresën Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, edhe pse sipas Ekstraktit Historik të Shoqërisë rezulton se kjo adresë ka qënë aktive deri në datën 21.04.2015.

2. Referuar Ekstraktit të shoqërisë, rezulton se drejtuesi teknik i shoqërisë është njëherësh edhe administrator, cka bie në kundërshtim me ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, ku thuhet se drejtuesi teknik i shoqërisë duhet të jetë me kohë të plotë pune. Në rastin konkret drejtuesi teknik nuk është me kohë të plotë pune pasi ai është i ngarkuar edhe me një detyrë tjetër, atë të administratorit të shoqërisë.

3. Nuk ka paraqitur tabelën e “Formularit të ofertës” sipas formatit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, por ka paraqitur një version tjetër. Në DST “Formulari i ofertës” është si në vijim:

Shtojca 1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

** * **

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendrojeve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	3 Vendroje me sherbim 24 oresh	(12)	(3)	(4.98)	(X)	(X)
2.	2 Vendroje me sherbim 16 oresh, Turn I dhe Turn II	(12)	(2)	(3.32)	(X)	(X)
3.	1 Vendroje me sherbim 16 oresh, Turn I dhe Turn III	(12)	(1)	(3.32)	(X)	(X)
	Oferta Neto ne total					(X)
	TVSH (%)					(X)
	Oferta total					(X)

Ndërkohë rezulton se “Formulari i ofertës”, i paraqitur nga operatori ekonomik është ndryshuar në kolonat 1,2,3,4,5 për rrjedhojë e gjithë oferta është në kundërshtim me kërkesat e “Formularit të Ofertës” së publikuar në DST [...].

4.Gjithashtu në DST, në shtojcën 1-Sqarime, është shprehur qartë:

1. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, me 2 turne (turni I+II) me (3.32 roje) dhe me 2 turne (turni I+III) me (3.32 roje) sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

Ndërkohë që opertaori ekonomik “International Security Albania” sh.p.k ka paraqitur preventivin si në vijim:

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%
5.	Shpenzime për 1-roje në muaj
6.	Shpenzime për 1-vendroje në muaj pa tvsh

Preventivi i mësipërm i paraqitur nga operatori ekonomik ndryshon nga preventivi i kërkuar nga AK pasi ka 6 rreshta, pra është i modifikuar. Të tre preventivët e paraqitur për tre llojet e vendrojeve janë në kundërshtim të plotë me dst.

Operatori ekonomik është i detyruar të përgatisë ofertën në përputhje të plotë me DST e publikuara nga autoriteti ontraktor dhe cdo devijim apo ndryshim i tyre e bën ofertën të pavlefshme dhe përbën kusht për skualifikim.

5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik është nën koston minimale ligjore të lejuar. Përlllogaritja e saktë dhe ligjore është si në vijim:

Llogaritja për 3 vendroje me tre turne me 4.98 roje për një vendroje , gjithsej 14.94 roje.

Paga bazë = 36.000 lekë në muaj

Shtesa turni II = 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 3 orë x 206.89 lekë/orë x 20% x 3 vendroje / 14.94 roje gjithsej = 758.01 lekë në muaj për roje.

Shtesa Turni III = 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 8 orë x 206.89 lekë/orë x 50% x 3 vendroje / 14.94 roje gjithsej = 5.053,43 lekë në muaj për roje.

Total paga + shtesa = 41.811,44 lekë.

Sigurimet janë = 41.811,44 lekë x 16.7% = 6.982,51 lekë

Total paga + shtesat + sigurimet = 48.793,95 lekë për roje /muaj pa tvsh.

Total për 14.94 roje për 12 muaj = 48.793,95 lekë x 14.94 roje x 12 muaj = 8.747.779,35 lekë.

Llogaritja për 2 vendroje me dy turne , turni I dhe turni II (16 orë në ditë), me 3.32 roje për një vendroje, (gjithsej 6.64 roje).

Paga bazë = 36.000 lekë pa tvsh

Shtesa turni II = 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 3 orë x 206.89 lekë/orë x 20% x 2 vendroje / 6.64 roje gjithsej = 1.137,02 lekë.

Total paga + shtesat = 37.137,02 lekë në muaj.

Sigurimet janë = 37.137,02 lekë x 16,7% = 6.201,88 lekë pa tvsh.

Total paga + shtesat + sigurimet = 43.338,9 lekë për roje/muaj pa tvsh.

Total për 6.64 roje për 12 muaj = 43.338,9 lekë x 6.64 roje x 12 muaj = 3.453.243,55 lekë pa tvsh.

Llogaritja për 1 vendroje me dy turne, turni I dhe turni III (16 orë në ditë), me 3.32 roje për një vendroje , (gjithsej 3.32 roje).

Paga bazë = 36.000 lekë pa tvsh

Shtesa turni III = 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 8 orë x 206.89 lekë/orë x 50% x 1 vendroje / 3.32 roje gjithsej = 7.580,15 lekë.

Total paga + shtesat = 43.580,15 lekë në muaj.

Sigurimet janë = 43.580,15 lekë x 16,7% = 7.277,88 lekë pa tvsh.

Total paga + shtesat + sigurimet = 50.858,03 lekë për roje/muaj pa tvsh.

Total për 3.32 roje për 12 muaj = 50.858,03 lekë x 3.32 roje x 12 muaj = 2.026.183,91 lekë pa tvsh.

Totali për 6 vendroje = 8.747.779,35 lekë + 3.453.243,55 lekë + 2.026.183,91 lekë = 14.227.206,81 lekë pa tvsh.

6. Data e certifikatës së drejtuesit teknik të kësaj shoqërie është e pasaktë pasi data e saj është e korrigjuar.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit është theksuar në mënyrë taksative se:

“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rremë e të pasaktë, konsiderohen si kushte për skualifikim.”

7.Operatori ekonomik disponon faturat tatimore si në vijim:

A. Faturën nr. 183, datë 18.01.2018, lëshuar nga AES-Communication sh.p.k për 1 copë repetitor.

B.Faturën nr.261, datë 14.08.2018, lëshuar nga AES-Communication sh.p.k për:

- 6 copë elektrik dore
- 6 copë spray neoparalizues
- 6 copë jelek antiplumb

C.Faturën nr.02, datë 18.10.2017, lëshuar nga nga shitësi “diagnostic AL” sh.p.k për:

- Walkie talkie copë 30
- Dedektor metali copë 24
- DVR copë 5
- CTV copë 20
- A-2060 copë 1

D. Faturën nr. 497, datë 16.11.2017, lëshuar nga shitësi “Gjergjefti” sh.p.k për:

- 17 copë elektroshok

E. Faturën nr. 09, datë 19.10.2017, lëshuar nga shitësi “Hasa-l” sh.p.k për:

- Zinxhir policie copë 20
- Shkop gome copë 20

F. Faturën nr.28, datë 18.05.2015, lëshuar nga shitësi “Migena Vrekaj” sh.p.k për:

- 25 copë walkie talkie;

G. Faturën nr. 950, datë 15.01.2015, lëshuar nga shitësi “Neptun” sh.p.k për:

- 1 copë televizor;

H. Faturën nr. 09, datë 11.02.2015, lëshuar nga shitësi “Gjergjefti” sh.p.k për zërat si në vijim:

- Bilbila copë 8
- Rrip mesi copë 6
- Këllëf radio copë 6
- Unaza copë 10
- Shkop gome copë 10
- Xhup copë 1
- Pantallona copë 1

I.Faturën nr. 10, datë 11.02.2015, lëshuar nga shitësi “Gjergjefti” sh.p.k për:

- Pranga copë 10
- Tabela copë 2

J.Faturën nr.54, datë 12.05.2015, lëshuar nga shitësi “Gjergjefti” sh.p.k për:

- Rrip mesi copë 8
- Shkopinj gome copë 8
- Pranga copë 8
- Tabela copë 3

K.Faturën nr. 16, datë 23.02.2015, lëshuar nga “Gjergjefti” sh.p.k për:

- Xhuboks copë 2



- Rrip mesi copë 2
- Këllëf radio copë 2
- Shkop gome copë 2
- Unaza copë 2
- Pranga copë 2

L.Faturën nr. 2851, datë 18.02.2015, lëshuar nga shitësi “Rogat Security Group” sh.p.k për:

- 5 copë radio dore

M.Faturën nr. 492, datë 25.04.2015, lëshuar nga shitësi “Fre” sh.p.k për:

- Kompjuter copë 3
- Monitor copë 3

N. Faturën nr.32, datë 25.05.2015, lëshuar nga shitësi “Migena Vrekaj” sh.p.k për:

- CTV kamera copë 40
- DVR copë 2

O.Faturën nr. 163219597, datë 11.05.2015, lëshuar nga shitësi “Distribrands” sh.p.k për zërat:

- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0
- Celular Samsung E1200 Black R0



Public Health Sector

P.Faturen nr.33, datë 25.05.2015, lëshuar nga shitësi “Migena Vrekaj” sh.p.k për

- Sistem alarmi copë 18
- DVR copë 6

Q.Faturën nr.345, datë 26.06.2015, lëshuar nga shitësi “Gleni” sh.p.k për:

- Wirless copë 125
- Web camera copë 21
- Switch për camera copë 38
- Karikues copë 220

R.Fturën nr.135, datë 03.07.2015, lëshuar nga shitësi “Neptun” sh.p.k për:

- 1 copë N

S.Faturën nr. 2779, datë 24.07.2015, lëshuar nga shitësi “PC Store” sh.p.k për:

- 1 copë printer HP

T.Faturën nr.06, datë 29.12.2015, lëshuar nga shitësi “Migena Vrekaj” sh.p.k për:

- CTV camera copë 20
- CTV camera copë 54
- CTV camera copë 102
- DVR copë 7
- DVR copë 4
- HDD 500GB copë 6
- Kabëll kam 8360 m
- Aparat marrës copë 6
- Monitor copë 1
- Cabinet rak copë 1
- Cabinet 60*60 copë 2
- Mikrofon copë 37
- Kompjuter copë 1
- Konektor bnc copë 900

U.Faturën nr.247, datë 04.09.2015, lëshuar nga shitësi “Ëest Alarm” sh.p.k për:

- Hac copë 8
- DVR 5108 copë 1
- DVR 5108 copë 1
- IRW copë 1
- BNC krimp copë 300
- Adapter copë 54
- IPC copë 9
- HAC copë 14
- HAC copë 2
- 4mmm lens copë 135
- CA-DW copë 15
- CA-DW copë 27
- DVR copë 10
- DVR copë 10
- XS2C copë 20



V.Faturën nr.351, datë 03.11.2015, lëshuar nga shitësi “Ëest alarm” sh.p.k për zërat si në vijim:

- SP4000 copë 1
- Metal box copë 1
- Trato e plastifikuar copë 1
- Bateri copë 1
- Gsm copë 1
- K5636 copë 1
- WS-20H sirenë e jashtme copë 1
- ProPc 476 PIR dedektor copë 4

- OP-D 6AB

Ë.Faturën nr.75, datë 24.02.2016, lëshuar nga shitësi “Gjergjeji” sh.p.k për:

- 5 copë dedektor

X.Faturën nr.443, datë 31.01.2017, lëshuar nga shitësi “Army Guard Security” sh.p.k për 15 copë bodyguard spray.

Së pari, nga verifikimi i faturave të mësipërme rezulton se operatori nuk disponon:

- Jo më pak se 6 spray neuroparalizues

Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht:

“Me qëllim parandalimin e veprimeve kriminale e personave që hyjnë apo dalin nga institucioni, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 6 spray neuroparalizues.

Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit, operatori ekonomik duhet të paraqesë : a) fatura tatimore e shitjes, e firmosur nga të dyja palët dhe e vulosur nga shitësi; b) Pagesën që vërteton vlerën e blerjes së pajisjeve; c) Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;

Për rastet kur keto pajisje janë blerë jashtë vendit, operatori ekonomik duhet të paraqesë: a) Deklaratën e zhdoganimit nëpërmjet të cilës vërtetohet zhdoganimi i pajisjeve; b) Deklaratën e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve”.

Fatura nr.443, datë 31.01.2017, paraqitur nga operatori ekonomik, lëshuar nga shitësi “Army Guard Security” sh.p.k për “bodyguard spray copë 15”, nuk jep informacionin e kërkuar në kriter (spray neuroparalizues), por jep informacion se kush e mban këtë spray dhe se çfarë funksioni kryen nuk e specifikon.

Edhe sikur për një moment të konsiderojmë se ky dokument përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor, sërish fatura tatimore e shitjes e referuar më sipër, është e parregullt në aspektin formal pasi ndryshe nga sa është kërkuar në kriterin e referuar më lart, ajo është e firmosur dhe vulosur nga pala shitëse dhe nuk është kundërfirmosur nga pala blerëse (pra kemi mosshprehje vullneti të njëjës palë) si e tillë cilësohet e parregullt e në kundërshtim me kriterin e mësipërm.

Gjithashtu, operatori ekonomik ka paraqitur faturën tatimore nr.262, datë 14.08.2015 për 6 copë spray neuroparalizues si dhe pagesën në Raiffeisen Bank.

Ndërkohë që operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve.

Pra operatori nuk përmbush tërësisht kriterin kualifikues për asnjë nga këto fatura.

Së dyti, nga verifikimi i faturave të mësipërme rezulton se operatori nuk disponon:

- Jo më pak se 6 radio dore.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht:

“Me qëllim parandalimin e veprimeve kriminale dhe kontrollin e personave që hyjnë apo dalin nga institucioni, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 6 radio dore. Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë:

- Fatura tatimore e shitjes e firmosur nga të dyja palët dhe e vulosur nga shitësi e pagesën përkatëse për të.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik disponon faturën nr.2851, datë 18.02.2015, lëshuar nga shitësi “Rogat Security Group” sh.p.k për radi dore copë 5, duke përmbushur kriterin

vetëm për 5 radio dore, nga 6 të kërkuara. Ndërsa fatura nr.02, datë 18.10.2017, lëshuar nga shitësi “Diagnostic AL” sh.p.k për walkie talkie copë 30, nuk jep informacion për ato që kërkohet nga autoriteti që është radio dore për më tepër walkie talkie, të cilat janë pajisje të kufizuara në transmetim të valëve, ndryshe nga radiot e dorës profesionale. Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar walkie talkie por radio dore.

Pra operatori ekonomik nuk përmbush tërësisht kriterin kualifikues.

Së treti, nga verifikimi i faturave të mësipërme rezulton se operatori nuk disponon:

- Jo më pak se 6 elektrik dore.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht:

“Me qëllim kontrollin e objektit gjatë natës ose në rast të shpërthimit të energjisë elektrike, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 6 elektrik dore. “Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë: a) Fatura tatimore e shitjes e firmosur nga të dyja palët dhe e vulosur nga shitësi; b) Pagesën që vërteton vlerën e blerjes së pajisjeve; c) Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve; Për rastet kur këto pajisje janë blerë jashtë vendit, operatori duhet të paraqesë: a) Deklaratën e zhdoganimit nëpërmjet të cilës vërtetohet zhdoganimi i pajisjeve; b) Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve.” Operatori ekonomik ka paraqitur faturën tatimore nr.262, datë 14.08.201, për 6 copë elektrik dore si dhe pagesën në Raiffeisen Bank.

Ndërkohë që operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE “Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve”. Pra operatori nuk përmbush tërësisht kriterin kualifikues.

Së katërti, nga verifikimi i faturave të mësipërme rezulton se operatori nuk disponon:

- Jo më pak se 6 jelek antiplumb;

Në kriteret e vecanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit është kërkuar:

“Me qëllim ruajtjen e jetës së punonjësve të shërbimit, grupeve të gatshëm nga veprimet kriminale të personave që hyjnë apo dalin nga institucioni, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 6 jelek antiplumb.

Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë: a) Fatura tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;

Për rastet kur këto pajisje janë blerë jashtë vendit, operatori duhet të paraqesë: a) Deklaratën e zhdoganimit nëpërmjet të cilës vërtetohet zhdoganimi i pajisjeve; b) Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve.”

Operatori ekonomik ka paraqitur faturën tatimore nr. 262, datë 14.08.2018 për 6 copë jelek antiplumb si dhe pagesën në Raiffeisen Bank.

Ndërkohë operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE “Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve”. Pra operatori nuk përmbush tërësisht kriterin kualifikues.

Së pesti, nga verifikimi i faturave të mësipërme rezulton se operatori nuk disponon:

- 1 Sistem radiokomunikimi;

Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht:

“Operatori duhet të disponojë jo më pak se 1 sistem radiokomunikimi, të vërtetuar me fatura tatimore, pagesat përkatëse dhe deklarin e faturave në sistemin elektronik të tatimeve”.

Ndërkohë që në të gjitha faturat e mësipërme, operatori ekonomik nuk ka specifikuar në asnjë zë të tyre se disponon sistem radiokomunikimi por thjesht radio dore, camera sirena dvr, sistem alarmi dhe pajisje që nuk kanë lidhje me kërkesën kualifikuese. Pra operatori nuk e përmbush kriterin kualifikues.

8. Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 1 Inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni ose specialist ekuivalent me ta si psh Inxhinier IT me kontratë pune. Gjithashtu të paraqitet Diploma, Kontrata e Punës për Inxhinierin.

Per operatorët ekonomik që nuk kanë në staf një inxhinier, duhet të paraqesin:

- Kontrata shërbimi nënshkruar me një kompani të licencuar për këtë lloj shërbimi; ose
- Kontrata shërbimi nënshkruar me një inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni i cili është i licencuar për ofrimin e këtij shërbimi;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili operator ekonomik në të kundërt përben kusht për skualifikim.”

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e shërbimit datë 13.08.2018, nënshkruar me subjektin Migena Vrekaj. Operatori ekonomik ka dështuar të përmbushë kriterin e kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë licencë për të vërtetuar se ky person është i licencuar për këtë shërbim.

9. Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 ”Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi Qarkun Tiranë. Periudha e vlefshmërisë së Licencës/Autorizimit duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës.”

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik disponon:

- Licencë/Autorizim Individual për përdorim frekuencash nr.1423, datë 21.10.2010 për radiokomunikim me zonë mbulimi qytetin Tiranë.

Operatori ekonomik ka dështuar të përmbushë kriterin kualifikues pasi nuk disponon licencë AKEP për radiokomunikim, me zonë mbulimi qarkun Tiranë.

Nga sa më sipër del qartë se operatori ekonomik nuk i përmbush kërkesat e publikuara në dokumentat e tenderit, për këtë arsye kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k.

Gjithashtu ankimesi ngre pretendime për shoqërinë “Pelikani Security Group” sh.p.k pasi: kjo shoqëri nuk plotëson kërkesat e AK-së për listpagesat e paraqitura për periudhën prill-qershor 2018 nuk janë të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve; nuk ka shlyer detyrimet financiare ndaj Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për vitin 2017; Vërtetimi i DPV Tiranë i paraqitur nga shoqëria nuk është në përputhje me kriteret e AK-së, pasi është lëshuar para afatit prill 2018 dhe nuk përmbush kriterin për sa i përket masave administrative dhe ngjarjeve të ndodhura, sepse ka masa të marra për ngjarje, ka ngjarje të ndodhura 2 (dy) brenda viti 2017; ka detyrime ndaj organeve tatimore; nuk ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat vendore; nuk ka paraqitur faturë që vërteton posedimin e minimalisht 6 spray neuroparalizues; oferta është nën koston ligjore pasi në formularin e ofertës totali për secilën nga vendrojet nuk përputhet me përlogaritjet konkrete sipas të dhënave të kërkuara; nuk ka paraqitur deklaratë të gjendjes gjyqësore dhe deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme; vërtetimi për shlyerjen e tatimeve nuk jep informacion për

muajin gusht 2018; në të gjitha shtojcat objekti i prokurimit është i ndryshëm nga ai i procedurës së shpallur nga AK; nuk përmbush kriterin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike; nuk ka paraqitur raportet e auditimit nga ekspertë kontabël të licencuar; nuk përmbush kriteret për kontrata të ngjashme; nuk përmbush kriterin për armët; nuk përmbush kriterin për 1 inxhinier elektronik/telekomunikacioni ose ekuivalent me të; nuk përmbush kriteret për 6 elektik dore, 6 radio dore, 6 jelek antiplumb për 1 sistem radiokomunikimi dhe 2 automjete.

Së fundi ankimuesi kërkon të mbetet i skualifikuar shoqëria “Leksi Security” sh.p.k pasi: nuk ka paraqitur asnjë dokument që ka paguar detyrimet e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore; nuk ka paraqitur listpagesat për periudhën mars-prill-maj qershor 2018; nuk ka paraqitur asnjë dokument për 1 inxhinier elektronik/telekomunikacioni ose specialist ekuivalent; në vërtetimin e DVP nuk jepet informacion për masat e marra për vitin 2017; nuk përmbush kriterin për 6 armë brezi, për 6 jelek antiplumb; oferta ka gabime aritmetike; nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike [...]”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.2095/1 prot., datë 27.09.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 28.09.2019 operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komsionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendohet se ankimuesi nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor brenda afateve ligjore.

II.6. Në datën 17.10.2018 është protokolluar në Komsisionin e Prokurimit Publik me nr.1538/2 prot, shkresa nr.2260/1 prot., datë 10.10.2018 e autoritetit kontraktor, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

Public Health Sector

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen skualifikimit të operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k se:

“a- Nuk ploteson kriterin për Akt-miratimin e Salles Operative pasi sipas ligjit 75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit të Brendshëm Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike Kreu VII Germa D pika 5 thote shprehimisht se Miratimi i Qendres së kontrollit të SHPSE-ve behet nga Drejtori i Drejtorise Vendore të Policise, bazuar ne KSHKC-se ne çdo dy vjet sipas modelit bashkelidhur ketij udhezimi. AktMiratimi i

Qendres se Kontrollit, i paraqitur nga O.Ekonomik Eurogjici Security, eshte i dates 27.08.2015, eshte jashte afatit 2-vjecar, sic parashikon udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem, Kreu VII Germa D pika 5”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas shkresës nr.2019/1 datë 27.09.2018 me objekt: “Kthim përgjigje ankesës nr. 2029 prot., datë 18.08.2018” të autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit, lidhur me arsyen e parë të skualifikimit të shoqërisë “Toni Security” sh.p.k sqarohet si vijon:

“Përsa i përket pikës së parë të skualifikimit është vendosur gabimisht operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k pasi arsya e skualifikimit është për operatorin ekonomik “Toni Security” sh.p.k pasi është skualifikuar për arsye se:

“Nuk ploteson kriterin per Akt-miratimin e Salles Operative pasi sipas ligjit 75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike Kreu VII Germa D pika 5 thote shprehimisht se Miratimi i Qendres se kontrollit te SHPSE-ve behet nga Drejtori i Drejtorise Vendore te Policise bazuar ne KSHKC-se ne çdo dy vjet, sipas modelit bashkelidhur ketij udhezimi. AktMiratimi i Qendres se Kontrolli, i paraqitur nga O.Ekonomik Toni Security eshte i dates 11.11.2015, eshte jashte afatit 2-vjecar sic parashikon udhezimi nr. 130, datë 5.3.2018 i Ministrit te Brendshem Kreu VII Germa D pika 5, pasi ju vetë konfirmoni se salla operative është miratuar me datë 11.11.2015, pra jashtë afatit 2-vjecar.”

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 5 e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

“Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit për Qarkun Tirane SHPSF si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik.”

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Toni Security” shpk ka dorëzuar:

- Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr. 96/272 protokolli datë 11.11.2015 lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë Tiranë, me anë të së cilës vërtetohet se: “Subjekti “Toni Security”, kat 1.3.A, “ Bazuar në kërkesën e nenit 22 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Kapitulli V, gërma “B” dhe “C” të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike Qendra e Kontrollit të Subjektit SHPSF “Toni Security” nënkategoria I.3.A, gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.”
- Shkresën nr. 259/264 prot, datë 30.07.2018 për subjektin “Toni Securiy” sh.p.k, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ku ndër të tjera konstatohet se: “Ka miratuar Qendrën e Kontrollit në selinë qendrore në DVP Tiranë nr.96/272 prot., datë 11.11.2015 me adresë në Rr. “Lidhja Prizrenit”, pall 4, ap.3,Tiranë.”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në nenin 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.5. Në nenin 22 të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikohet se: “1. Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë. 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike. 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë”

III.1.6. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se shoqëria “Toni Security” sh.p.k, në plotësim të kërkesës për Qendrën e Kontrollit të SHPSF ka paraqitur Akt Miratimin për Qendrën e Kontrollit të SHPSF, me nr. 96/272 protokolli, datë 11.11.2015, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë Tiranë, me anë të së cilës vërtetohet se: “Subjekti “Toni Security”, kat 1.3.A, “Bazuar në kërkesën e nenit 22 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Kapitulli V, gërma “B” dhe “C” të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike Qendra e Kontrollit të Subjektit SHPSF “Toni Security” nënkategoria 1.3.A, gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike”. Akti i mësipërm është lëshuar në zbatim të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si edhe aktit nënligjor në fuqi në kohën e lëshimit të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike” (i shfuqizuar) .

III.1.8. Në Udhëzimin Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” Kapitulli VI, gërma “B” dhe “C” parashikojnë se:

1. Shoqëritë private të sigurisë fizike që ushtrojnë aktivitet në një ose disa njësi administrative duhet të kenë qendër kontrolli në çdo njësi administrative, ku të tregohet adresa fizike dhe elektronike, si dhe stema e shoqërisë.

2. Subjektet e SHPSF-ve që ushtrojnë veprimtarinë në disa njësi administrative, duhet të kenë qendër kontrolli me sistem ndërlidhjeje dhe marrje të sinjaleve të alarmit dhe sinjalit video në çdo njësi administrative.

3. Subjektet e licencuara për shërbimin privat të sigurisë fizike janë të detyruara të përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike.

4. Qendra e kontrollit të jetë e pajisur me sistem ndërlidhës e radiokomunikim dhe radioalarm, të cilat bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të radiondërlidhjes pranë çdo objekti në ruajtje.

5. Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL dhe ruajtjes së sinjalit video.

6. Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike duhet të pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual.

7. Miratimi i qendrës së kontrollit të SHPSF-ve bëhet me komision nga sektori i rendit publik i Drejtorisë së Policisë Vendore. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve të mëposhtme.

C. Organizimi i shërbimit në qendrën e kontrollit

1. Qendra e kontrollit kryen detyra për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e dinamikës të SHPSF- së, për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore sportive fetare e politike dhe sigurimin e vlerave monetare dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.

2. Për verifikimin e sinjaleve të alarmit të SHPSF-së organizojnë shërbim me grupe shërbimi të pajisur me armatim, me mjete speciale për ndërhyrje në raste emergjence, si dhe automjete, motorë për lëvizjen e tyre.

3. Qendra e kontrollit vendoset në ambientet e SHPSF-së dhe të ofrojë kapacitetin dhe potencialin e duhur teknik për realizimin e veprimtarisë të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Çdo subjekt i SHPSF-së duhet të ketë në administrim qendrën e tij të kontrollit (pronësi/qira) në çdo njësi administrative që ushtron aktivitetin e saj.

4. Qendra e kontrollit realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimi në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrja dhe verifikimi i sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) nëpërmjet mënyrave të ndryshme, si:

a) nëpërmjet telefonit celular (GSM);

b) nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID);

c) nëpërmjet rrugëve valore (radio).

5. Detyrat e punonjësit të shërbimit (operatorit) të SHPSF-së:

a) rregulloren e funksionimit të shërbimit në sallën operative;

b) librin e instruktazhit me pjesë (ekstrat) nga aktet normative;

c) evidencën e regjistrimit të sinjaleve të alarmit;

ç) librin e shënimeve;

d) numërorin telefonik të drejtuesve të shoqërisë, të punonjësve të shërbimit sipas objekteve, të titullarëve të subjekteve që shoqëria ka lidhur kontrata dhe të shërbimeve të urgjencës dhe të sallave operative të Policisë së Shtetit;

dh) librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit;

e) evidenca e regjistrimit të bisedave telefonike me celularë;

ë) kasafortë metalike për mbajtjen e armatimit dhe pajisjeve speciale;

f) shërbimi në qendrën e kontrollit kryhet nga punonjësi i shërbimit (operatori) 24 orë në 24.

6. Pajisjet e qendrës së kontrollit dhe të dhënat e siguruar nga përdorimi i tyre vihen në dispozicion sa herë që kërkohet nga Policia e Shtetit, organet e prokurorisë, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

III.1.9. Me anë të Udhëzimit Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-së” u shfuqizua Udhëzimi Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

Në kreun VI Mjetet, pajisjet e shërbimit dhe Qendra e Kontrollit të SHPSF-ve gërma “B” pika 6 të Udhëzimit Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-së” parashikohet se “ Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet me komision nga Sektori i Rendit Publik në Drejtorinë Vendore të Policisë, me afat 4 vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit, bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve.”

III.1.10. Me anë të Udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” u shfuqizua Udhëzimi nr Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-së”

Në kreun VII “Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së” gërma “C” të Udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” parashikohej se “ 5. Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve”

Në Kreun IX “ Dispozitat Përfundimtare” pika 6 të Udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” parashikohet se “6. Aktet e nxjerra në zbatim të udhëzimit nr. 308, datë 22.5.2017, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”, mbeten në fuqi”

III.1.11. Gjithashtu, në datën 21.06.2018 me anë të shkresës nr.854/3 protokolli datë 21.06.2018, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit duke i

kërkuar informacion në lidhje me vlefshmërinë e Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të lëshuara sipas Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017.

III.1.12. Në datën 04.07.2018 me anë të shkresës nr. 4986/2 protokoli datë 04.07.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në kthim përgjigje ndër të tjera Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ndër të tjera sqaron se: *“..... Aktet e Miratimit për Qendrat e Kontrollit të SHPSF-ve të miratuara në zbatim të Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017 kanë qenë pa afat. Këto akte do të konsiderohen të vlefshme deri në momentin e kryejres së procedurave të miratimit apo refuzimit nga Drejtoritë Vendore të Policisë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018.”*

III.1.13. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, referuar ligjit nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”* vlefshmëria e certifikimit të Qendrës së Kontrollit nuk është e kufizuar në kohë (afat ligjor). Rregullimi i mëtejshëm i procedurës, mënyrës dhe afateve të vlefshmërisë së certifikimit rregullohet nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se subjekti “Toni Security” shpk ka miratuar Qendrën e Kontrollit me anë të Akt Miratimit për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr. 96/272 protokoli datë 11.11.2015 lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë Tiranë, akt miratim i lëshuar në zbatim të Udhëzimit Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm *“Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”*. Referuar Udhëzimit në fuqi në kohën e lëshimit të Akt Miratimit, KPP konstaton se nuk parashikohet afat vlefshmërie në lidhje me Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, SHPSF. Gjithashtu, Udhëzimi pasardhës Nr. 308 datë 22.5.2017 të Ministrit të Brendshëm *“Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shpsf-së”* me anë të të cilit u shfuqizua Udhëzimi Nr. 157, datë 1.4.2015 të Ministrit të Brendshëm *“Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”*, parashikon afat vlefshmërie 4 vjeçar, dhe nuk shfuqizoi aktet e nxjerra sipas udhëzimit paraardhës, ndërsa Udhëzimi aktual në fuqi parashikon afat vlefshmërie 2 vjeçar në lidhje me Akt Miratimin e Qendrës së Kontrollit dhe nuk shfuqizoi aktet e nxjerra sipas udhëzimit paraardhës. KPP gjykon se marrëdhënia juridike rregullohet nga ligji/akti nënligjor në fuqi në momentin e krijimit të saj.

III.1.14. Gjithashtu, KPP konstaton se në shkresën nr. 259/264 prot, datë 30.07.2018 për subjektin “Toni Securiy” sh.p.k, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, kjo drejtori ndër të tjera shprehet se *“Ka miratuar Qendrën e Kontrollit në selinë qendrore në DVP Tiranë nr.96/272 prot., datë 11.11.2015 me adresë në Rr. “Lidhja Prizrenit”, pall 4, ap.3,Tiranë”*, pra është i njëjti akt miratim me atë të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Gjithashtu, në rastin konkret, referuar trajtimit të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka sqaruar se: *“Aktet e Miratimit për Qendrat e Kontrollit të SHPSF-ve të miratuara në zbatim të Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017 kanë qenë pa afat. Këto akte do të konsiderohen të vlefshme deri në momentin e kryejres së procedurave të miratimit apo refuzimit nga Drejtoritë Vendore të Policisë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018.”*

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit se: “b- Nuk ka paraqitur certifikatat e trajnimit për personelin te SHPSF-së për përgjegjës shërbimi për SHPSF-në, për operator për Qendrën e Kontrollit, për punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve të alarmit te parashikuar ne nr. 130, datë 5.3.2018 Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike KREU III germa A pika 2 . c- Nuk keni paraqitur certifikatat e vlefshme per punonjesit e sherbimit sipas ligjit 75/2014”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 3 e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim leshuar jo me pare se muaji Prill 2018, leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Tirane, me ane te cilit te jepet informacion per:

- Numrin e punonjesve te sherbimit jo me pak 25
- Jo me pak se 5 Operator te Qendres se Kontrollit
- Jo me pak se 2 pergjegjes sherbimi
- Nuk ka masa administrative per periudhen 01.01.2017 deri ne 31 Mars 2018
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per periudhen 01.01.2017 deri ne 31 Mars 2018
- Nuk ka masa te marra per ngjarjet per periudhen 01.01.2017 deri ne 31 Mars 2018.”

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, ankimuesi ka paraqitur shkresën nr. 259/264 prot, datë 30.07.2018 për subjektin “Toni Security” sh.p.k, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë sipas së cilës numri i punonjësve të shërbimit të certifikuar nga DVP Tiranë është 125 (njëqind e njëzet e pesë).

III.2.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.3. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.2.4. Ndërsa në nenin 26, pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në

përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përkatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr.REF- 80800-07-26-2018 me objekt: “*Shërbimi me roje private për ASHR*”, me fond limit 14.227.576 lekë pa TVSH, nuk janë kërkuar si kriteret kualifikimi që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duhet të paraqesin *certifikatat e trajnimit për personelin të SHPSF-së për përgjegjësi shërbimi për SHPSF-në, për operator për Qendrën e Kontrollit, për punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve të alarmit si dhe certifikatat e vlefshme për punonjësit e shërbimit*, kërkesa të cilat do të përbënin një detyrim ligjor për tu përmbushur nga ofertuesit, sc parashikohet në nenin 46 si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriteret që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet

e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, si më sipër cituar, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur pretendimin e shoqërisë “Toni Security” sh.p.k se: “Referuar ekstraktit të shoqërisë, rezulton se operatori ekonomik në datën 21.04.2015 ka shtuar dhe mbyllur adresat si në vijim:

-Është shtuar adresa Tiranë, Njësia Bashkiake nr.9, Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9.

-Është hequr adresa Tiranë, Rruga e Durrësit, ish Uzina Tirana, Laprakë.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit AK ka kërkuar:

“Vërtetim lëshuar nga Bashkia/Njësi administrative me anë të të cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2015-2016-2017 për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas ekstraktit historik lëshuar nga QKR.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm, referuar informacioneve nga Bashkia, rezulton se operatori ekonomik disponon dhe ka paraqitur dokumentacionin si në vijim:

- Vërtetim datë 26.02.2018, lëshuar nga Bashkia Tiranë, me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2018.
- Vërtetim datë 20.04.2017, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2017.
- Vërtetim datë 02.06.2015, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2017.
- Vërtetim datë 21.03.2014, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2011, 2012, 2013, 2014.

Nga sa më sipër rezulton se, operatori ekonomik ka dështuar në përmbushjen e kriterit për arsye se për adresën Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana,, subjekti nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Tiranë që të vërtetonte se ka shlyer taksat për vitin 2015 për adresën Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, edhe pse sipas Ekstraktit Historik të Shoqërisë rezulton se kjo adresë ka qënë aktive deri në datën 21.04.2015”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik e financiar”, pika 3, e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kushtit si më poshtë vijon:

Vertetim leshuar nga Bashkia/Njesi Administrative me ane te se cilit te vertetohet shlyerja e taksave per vitin 2015-2016-2017, per adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik leshuar nga QKR.

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “International Security Albania” shpk, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- “Ekstrakti i regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, si edhe Ekstraktin Historik,”
- Vërtetim datë 26.02.2018, lëshuar nga Bashkia Tiranë, me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2018.
- Vërtetim datë 20.04.2017, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2017.
- Vërtetim datë 02.06.2015, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2015.
- Vërtetim datë 21.03.2014, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Rruga e Durrësit, Ish Uzina Tirana, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2011, 2012, 2013, 2014.
- Vërtetim datë 20.05.2015, lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se për adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap.9, subjekti ka shlyer taksat vendore për vitin 2016.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.3.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.3.5. Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm.

Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.3.6. Neni 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se:


Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë:

- a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;*
- b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;*
- c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;*

III.3.7. Neni 9 i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar parashikon se:

Në taksat vendore përfshihen:

- 1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.*
- 2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.*
- 3. Taksa e fjetjes në hotel.*
- 4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.*
- 5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.*
- 6. Shfuqizohet.*
- 7. Shfuqizohet.*
- 8. Taksa e tabelës.*
- 9. Taksa të përkohshme.*



III.3.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.9. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore *per vitin 2015-2016-2017, per adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik leshuar nga QKR.* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “International Security Albania” shpk në përmbushje të këtij kriteri ky i fundit ka dorëzuar ekstraktet e QKR-së si dhe vërtetime lëshuar nga Bashkia Tiranë. Nga verifikimi i ekstraktit të regjistrimit tregëtar të ofertuesit objekt ankimimi rezulton se ky i fundit ushtron aktivitetin e tij ekonomik vetëm në Bashkinë Tiranë. Sipas ekstraktit të QKR-së, nga data e regjistrimit të tij në QKR deri me datë 21.04.2015, shoqëria “International Security Albania”

sh.p.k e ka patur adresën e aktivitetit: “*Rruga e Durrësit, ish Uzina Tirana Laprakë Tiranë*” dhe pas kësaj datë adresa e tij ndryshoi në: “*Njësia Bashkiake nr.9, Bulevardi Zogu i Parë, Pallati nr.55/1, Shkalla 1, Kati 2, Ap 9 Tiranë*”.

Pësa më sipër cituar rezulton se ka mangësi, pasi nuk është paraqitur vërtetim për pagesën e taksave vendore nga Bashkia Tiranë për vitin 2015, për adresën: “*Rruga e Durrësit, ish Uzina Tirana Laprakë Tiranë*” në të cilën shoqëria “International Security Albania” sh.p.k ka ushtruar aktivitet deri në datën 21.04.2015, sipas ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, (duke mos paraqitur vërtetim nga Bashkia Tiranë për shlyerjen e detyrimeve për taksat vendore në këtë adresë për vitin 2015).

Pretendimi operatorit ekonomik “Toni Security” qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “International Security Albania” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar pretendimi në pikën III.3.të arsyetimit dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interes të ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k për shoqëritë “Pelikani Security Group” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 13.09.2018, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i kryer nuk rezulton që ky operator ekonomik të ketë paraqitur ankesë në KPP në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k për shoqëritë “Pelikani Security Group” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k, nuk do të merren në shqyrtim

III.6. Nga shqyrtimi i ankesës së administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k, ka ngritur pretendime dhe ka parashtruar fakte për operatorët ekonomikë “International Security Albania” sh.p.k, “Pelikani Security Group” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k të cilat përbëjnë sekret tregëtar dhe informacion konfidencial, në kuptim të nenit 25 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*”, të ndryshuar, i cili disponohet vetëm në sistemin e prokurimeve elektronike.

Në nenin 25 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*”, të ndryshuar parashikohet se “*Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave*”.

Sa më sipër, KPP konstaton se, fshehtësia e procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, i parashikuar dhe nga *lex specialis*, shfaq një rëndësi të veçantë si në drejtim të mbrojtjes së nivelit më të lartë të interesit publik, por njëherazi shfaq edhe nivelin më të lartë të mbrojtjes së garancive procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në drejtim të ruajtjes së sekretit tregëtar, të dokumentacionit të dorëzuar nga këta të fundit në procedurat e prokurimit publik.

Akoma më tej, KPP, gjykon se, cënimi i fshehtësisë së procesit të zhvilluar, për të cilin, pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik marrin dijeni në një formë të ndryshme nga ajo e caktuar në ligjin për prokurimin publik, mbi të dhëna konfidenciale të ofertuesve, cilësohet shkelje e sekretit tregëtar të kompanive, pasi, përhapet informacion konfidencial i subjekteve tregëtare tek persona të paaautorizuar, informacion i cili, jo vetëm i shkakton dëm interesave tregëtare të shoqërive, por njëherazi cënon edhe procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Të ndodhur në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, shqyrtimi i çështjes së mësipërme është jashtë kompetencës lëndore të këtij të fundit. Referuar nenit 19/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”, ndaj dhe në zbatim të nenit 13 të *lex specialis*, Komisioni i Prokurimit Publik i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Public Health Sector

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF- 80800-07-26-2018 me objekt: “Shërbimi me roje private për ASHR”, me fond limit 14.227.576 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Shëndetësor Rajonal.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “International Security Albania” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 1538 prot., datë 28.09.2018.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Toni Security" sh.p.k..
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1538 Protokolli;

Datë 28.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

